

**NATASHA KALEMI,
MAJLINDA BUSHAJ**

**DËSHMI TË METODAVE TË REJA NË PROCESIN
E TË SHKRUARIT TË NXËNËSVE**

Zhvillimi i vullshëm i shoqërisë shqiptare dhe në mënyrë të veçantë ndikimi i madh që sollën ndryshimet e shpejta të teknologjisë bënë të mundur rritjen e shpejtë të informacionit. Në metodologjinë dhe strategjitë e reja të mësimdhënies të bazuara në filozofinë e zhvillimit të mendimit kritik dhe të nxënësve ndërvësues ekzistojnë një numër i madh teknikash mësimore bashkëkohore që vendosin nxënësin në qendër të vëmendjes, duke i dhënë mësuesit rol udhëheqës, orientues e drejtues në të gjithë tërësinë e procesit mësimor. Të shkruarit është mënyrë për të zhvilluar të menduarit, sikurse të folurit dhe të lexuarit. Gjatë kohës që nxënësit shkruajnë, ata përzgjedhin ide që janë të kuptimshme për ta dhe i regjistrojnë në kujtesë për përdorim të mëvonshëm, në situata të ndryshme. Të shkruarit i ndihmon nxënësit të qartësojnë më tej mendimet e tyre dhe kur përfshihen në këtë proces, ata mësojnë një llojshmëri metodash. Gjatë të shkruarit dalin plot të papritura që kanë të bëjnë me modelin, përmbajtjen, lexuesin, dhe përdorimin e burimeve të ndryshme. Të gjitha këto, por edhe të tjera janë pjesë e njohurive që duhet të zotërojnë shkruarët dhe që u mbivendosen njohurive të mëparshme, të cilat pasurohen me shtimin e përvojës.

Gjatë punës së përditshme si mësimdhënës ne vëmë re se shumë nxënës kanë vështirësi në të shprehur me shkrim. Ata nuk arrijnë dot të përmbledhin e të shprehin mendimet e tyre, të përshkruajnë, të analizojnë, të informojnë, të shpjegojnë, të krahasojnë apo të raportojnë diçka me shkrim, kjo për arsye se ata nuk janë mjaftueshëm të aftësuar të shkruajnë tekste të llojeve të ndryshme. Kjo është arsyeja e këtij studimi.

Në mësimdhënien bashkëkohore është kapërcyer metoda e hartimit¹, ajo është zëvendësuar me punët me shkrim.² Detyrat me shkrim luajnë rol

¹ Shih: Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, *Metodika e hartimit*, Tiranë, 1961; J. Çerepi, *Puna për zhvillimin e të folurit dhe përgatitja e nxënësve për hartim* (Klasat V-VI), Instituti i Studimeve dhe Botimeve Shkollore, Tiranë, 1965 etj.

² Në vitin 1997 Ministria e Arsimit dhe e Shkencës nxori një udhëzim në lidhje me konceptimin e temave të punëve me shkrim. Ndryshimet që pësoi lënda e gjuhës

të pazëvendësueshëm për aftësimin e nxënësve për të shprehurit me gojë e me shkrim. Historiku i mësimit të gjuhës shqipe na njeh me lloje të ndryshme punësh të pavarura me shkrim, duke filluar që nga detyrat e zakonshme brenda orës së mësimit dhe detyrat e shtëpisë. Didaktika e gjuhës shqipe përfshin diktimet, hartimet, punët me shkrim dhe esetë. Këto janë të nevojshme të përdoren edhe sot në çdo orë mësimi me nxënësit që kanë problem në të shkruar. Detyrë kryesore e mësuesit të gjuhës shqipe është që të kujdeset dhe të sigurojë një shkrim të mirë e të saktë të nxënësve, duke qenë gjithnjë kërkues ndaj nxënësve, por edhe drejtues i punës së tyre si për çdo linjë tjetër edhe për të shkruarit, duke përdorur edhe diktimin, si një formë pune me rëndësi. Diktimi është një formë e punës së diferencuar me nxënës me vështirësi në lexim-shkrim dhe një mundësi për forcimin e shprehive drejtshkrimore, drejtshqiptimore e të pikësimit. Ai mund dhe duhet të zërë vend në kohë të ndryshme të vitit shkollor si minidiktim, po ta quajmë kështu një 5-10 minutësh “provë” për zbatimin e rregullave drejtshkrimore nga nxënësit. *Diktimet janë forma të rëndësishme pune për të ushtruar nxënësit për çështje të ndryshme drejtshkrimore, por edhe për të verifikuar, për të diagnostikuar, kontrolluar, për të vlerësuar dhe për të ndërtuar punën në të ardhmen.*³

Prof. dr. **Njazi Kazazi** në veprën *Didaktikë e gjuhës shqipe* paraqet disa forma të mundshme të diktimeve për të lehtësuar punën e mësuesit.

Diktim me paralajmërim: Një nga format e këtij diktimi është rasti kur nxënësve u bëhet i njohur teksti që do të shkruhet gjatë orës së diktimit, në mënyrë që ata ta lexojnë paraprakisht. Një formë tjetër e diktimit me paralajmërim është përsëritja dhe përforcimi i rregullave drejtshkrimore, nga nxënësit bashkë me mësuesin, para zhvillimit të diktimit, gjatë të cilit nxënësit do të shkruajnë një tekst ku kërkohet zbatimi praktik i rregullave drejtshkrimore e drejtshqiptimore të trajtuara.⁴

shqipe, bëri që në programin lëndor të shkruarit të zhvillohej si rubrikë më vete, me objektiva e me kërkesa të ndryshme nga ato të mëparshmet. Tashmë të shkruarit shihej si një aftësi e domosdoshme për të mundësuar komunikimin mes njerëzve dhe për të plotësuar nevojat vetjake. Ky ndryshim në konceptimin e lëndës së gjuhës shqipe u shoqërua edhe me ndryshime në lëndën e leximit. U bë një ndryshim nga *hartim* që ishte quajtur deri në atë kohë në *punë me shkrim*.

³ Nj. Kazazi, N. Garuci, N. Zhabjaku, *Didaktikë e gjuhës shqipe*, botim i ShBLU-së, Tiranë, 2005, f. 253.

⁴ Nj. Kazazi, N. Garuci, N. Zhabjaku, *Didaktikë e gjuhës shqipe*, botim i ShBLU-së, Tiranë, 2005, f. 254.

Diktimi me të zgjedhur: Është forma më e vështirë e diktimeve prandaj duhet përdorur e zbatuar pasi nxënësit të kenë fituar njohuri të mjaftueshme gramatikore e drejtshkrimore. Diktimi me të zgjedhur lejon të merren tekste të gjata, ku ka shumë shembuj dhe raste të përdorimit të një rregulle të caktuar.

Diktim krijues: Mësuesi paraqet para nxënësve një tekst, i cili lexohet bashkërisht. Diskutohen problemet e drejtshkrimit e të pikësimit që gjejnë zbatim në tekstin e dhënë. Për kursim kohe, u kërkohet nxënësve ta rishkruajnë tekstin duke ndryshuar struktura të nënvizuara frazash e fjalish. Më pas diskutohet rreth problemeve drejtshkrimore e të pikësimit, ku nxënësit kanë bërë gabime, si rezultat i shkrimit në mënyrë krijuese. Një formë e këtij diktimi mund të jetë: Pasi nxënësit e lexojnë 2-3 herë tekstin e dhënë dhe pasi vihen në dukje problemet gjuhësore që synohet të kontrollohen, hiqet teksti dhe lihen nxënësit ta shkruajnë atë sipas kujtesës.

Vetëdiktimi: Nxënësit shkruajnë vetë një pjesë që kanë mësuar përmendsh. Ky lloj diktimi bën një lidhje të mirë në mes të drejtshkrimit dhe të drejtshqiptimit, kontrollon mirë aftësitë dhe shprehinë drejtshkrimore të nxënësve. Ndryshe nga rastet e tjera ku mësuesi shqipton fjalët dhe fjalitë vetë, pra nxënësi ka një farë orientimi, tani ai vetë është në pozitën e diktuesit dhe duhet të zgjidhë vetë alternativat që duhet të ketë. Pjesët e zgjedhura për vetëdiktim duhet të jenë të shkruara në gjuhën standarde.⁵

Diktim kontrolli: Ky diktim mund të përdoret me qëllim vlerësimi me notë të nxënësve. Për këtë arsye, teksti duhet të përmbushë disa standarde: të përfshijë sa më shumë çështje drejtshqiptimore, drejtshkrimore e të pikësimit, sepse do të shërbejë për diagnostikimin e objektivave që kanë arritur nxënësit.

Kopjimi është një formë e lehtë pune për ushtrimin e nxënësve në drejtshkrim. Nëpërmjet tij, duke u bazuar në një tekst të dhënë, ushtrohet në një shkallë të mirë vëmendja e nxënësve për probleme të caktuara drejtshkrimore dhe kujdesi i tyre për të shkruar drejt. Nga qëllimet e zhvillimit të tyre dhe rrugët metodike që ndiqen janë disa llojesh:

Kopjimi i plotë i një teksti bëhet me qëllim që nxënësi të përqendrojë vëmendjen në të gjithë tekstin që kopjon që, që veç anës figurative të përqendrojë vëmendjen edhe në problemet drejtshkrimore që ka aty. P.sh.: *Emrave me shkronja të zeza u shtoni përcaktorë etj.*

⁵ Nj. Kazazi, N. Garuci, N. Zhabjaku, *Didaktikë e gjuhës shqipe*, botim i ShBLU-së, Tiranë, 2005, f. 254.

Kopjimi me të zgjedhur është formë ushtrimi me qëllim përforcimi ku rëndësi të dorës së parë ka përcaktimi i kërkesës dhe udhëzimi i qartë i punës që do të kryejnë. Në bazë të kërkesës së shtruar nxënësit nuk kopjojnë gjithë tekstin, por vetëm ortogramet dhe togjet e fjalëve ku gjenden faktet e kërkuara. Ky lloj është një nga format e vështira të punës, sepse nxënësi duhet të ketë përgatitje të mjaftueshme për të qenë në gjendje të analizojë dhe të plotësojë kërkesat e vëna nga mësuesi.⁶

Kopjimi i një teksti që disa fjalë i ka në formën fillestare (që zakonisht janë në kllapa) është një formë mjaft e përhapur dhe me përdorim të gjerë.

Kopjimi i një teksti duke plotësuar disa fjalë e fjali. etj. (shih: Kazazi:253).

Prof. dr. **M. Gjokutaj**, format e ushtrimeve që ndihmojnë përsosjen e shprehive të të folurit dhe të të shkruarit të nxënësve, i grupon në këtë mënyrë: a. Ushtrime mbi përsosjen e teknikës së shkrimit: *kopjimi, diktimi, të shkruarit e një materiali të mësuar përmendsh*. b. Ushtrime në lidhje me aftësimin e nxënësve për të kompozuar: hartime sipas përpunimit të materialit letrar etj. c. Ushtrime me karakter praktik: punime me shkrim me karakter administrativ (plotësimi i fletëkërkesave dhe autobiografive, i vërtetimeve, fletëparaqitjes, fletëregjistrimeve etj.), punime me shkrim me karakter informative (hartimi i letrave, telegrameve, urimeve, lutjeve lajmërimi etj.).⁷

Qëllimi i strategjive të të shkruarit është t'u tregojmë nxënësve si të bëjmë shkrime të pëlqyeshme dhe t'u japim atyre mundësinë për të shkruar rregullisht me kuptim për qëllimet e tyre, për një mjedis dëgjues të vërtetë. Studiuesja Drita Kadriu shprehet se: "*Procesi i të shkruarit sjell ndryshime të thella në jetën e nxënësit si në dijet e tyre intelektuale, përmirësimin e fjalorit dhe gjuhën që e përdorin. Të shkruarit përmirëson aftësinë lexuese duke iu dhënë nxënësve mundësi që të "lexojnë si shkruet" sikurëse që të lexuarit u jep mundësi nxënësve që të "shkruajnë si shkruet."*"⁸

Aftësia e të shkruarit nuk është e lindur. Kjo aftësi bazë e domosdoshme për shumë profesione përftohet përgjithësisht gjatë procesit të shkollimit. Njohuritë gjuhësore të përfuara gjatë viteve të të nxënësve do të

⁶ Nj. Kazazi, N. Garuci, N. Zhabjaku, *Didaktikë e gjuhës shqipe*, botim i ShBLU-së, Tiranë, 2005, f. 253.

⁷ M. Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, ShBLU, Tiranë, 2009, f. 348.

⁸ D. Kadriu, *Strategjitë e mësimdhënies që i zhvillojnë tek nxënësit kompetencat: Komunikimi dhe të shprehurit si dhe kompetencën e të menduarit*, Java e shkencës, Prishtinë, 2015, f. 52.

mjaftonin për shkrimin e një teksti. Mjafton që të dimë e të njohim saktësisht kuptimin e fjalëve, rregullat gramatikore e ortografike të gjuhës me anë të së cilës dëshirojmë të shprehim mendimet tona.

Shumëllojshmëria e situatave të të shkruarit, qëllimet e ndryshme, lexuesit e ndryshëm, kontekstet e ndryshme janë të gjitha këto çështje që duhen kapërcyer, jo vetëm për atë që shkruan, por edhe për mësuesin gjatë punës së tij me nxënësit. Në këtë mënyrë, mësimdhënia për procesin e të shkruarit *nuk mund të shndërrohet në një proces mekanik të zbatimit të disa rregullave dhe udhëzimeve, që do të mund të shërbejnë si shabllone në situatave të ndryshme.*⁹ *Kështu procesi i komunikimit me shkrim nuk presupozon vetëm të qenurit i aftë fizikisht për të shkruar si dhe zotërimin e njohurive të përgjithshme gjuhësore, por sipas konteksteve e situatave të ndryshme shkruesi duhet të dijë të përzgjedhë e të përdorë saktësisht elementet gjuhësore dhe shprehjet specifike, dhe jo vetëm, por dhe t'i përmbahet kriterëve tekstuale që kërkojnë tipet e ndryshme të teksteve. Në varësi se kujt i shkruajmë, për çfarë a për kë shkruajmë, a për çfarë qëllimi ne shkruajmë rezultojnë lloje të ndryshme shkrimesh.*¹⁰

Për të pasur sukses puna për aftësimin e nxënësve, duhet që mësuesi të njohë mirë specifikat e shkrimeve të llojeve të ndryshme, por edhe nivelin e klasës në mënyrë që shkalla e vështirësisë të vijë duke u rritur pak e nga pak. Në qoftë se format e punëve me shkrim nuk përputhen me nivelin e përgatitjes gjuhësore të klasës nuk mund të shpresojmë për sukses në zhvillimin e aftësive të të shprehurit me shkrim.

Vendimet për procedurat dhe për metodat që përdor, mësuesi duhet t'ua përshtatë nxënësve, formimit dhe përvojave të tyre. *Klasa karakterizohet nga veprimtaria, jo pasiviteti; nga bashkëpunimi, jo konkurrenca; dhe shumë mundësi për të mësuar, krahas teksteve dhe situatave të drejtuara nga mësuesi.*¹¹

MODELE QË PËRMIRËSOJNË TË SHKRUARIN

Të shkruarit është mënyrë për të zhvilluar të menduarit, sikurse të folurit dhe të lexuarit. Gjatë kohës që nxënësit shkruajnë, ata zgjedhin ide që janë të kuptimshme për ta dhe i regjistrojnë në kujtesë për përdorim të

⁹ Shih: B. Musai, *Si të shkruajmë esse*, Tiranë 2009.

¹⁰ E. Bushati, *Evidentimi i problematikave të mundshme gjatë komunikimit me shkrim*, Buletin i Shkencave të Edukimit, Shkodër, 2013, f. 195.

¹¹ A. C. Orstein, *Kurrikula, bazat, parimet dhe problemet*, botim i ISP, Tiranë, 2003, f. 71.

mëvonshëm, në situata të ndryshme. Gjatë kohës që shkruajnë nxënësit kryejnë veprimet e mëposhtme:

- Shqyrtojnë ç'dinë dhe mendojnë.
- Gjejnë idetë dhe përzgjedhin ato që janë më të përshtatshme.
- Përpunojnë të shkruarit për t'ia përshtatur dëgjuesve, lexuesve, pjesëmarrësve në diskutim.
- Përzgjedhin me kujdes fjalët dhe frazat, për të ndërtuar kuptimin e dëshiruar.
- Miratojnë, pohojnë dhe përforcojnë ato që dinë.
- Qartësojnë mendimet e turbullta, me qëllim që t'ia komunikojnë të tjerëve.
- Analizojnë dhe vlerësojnë ato që kanë shkruar.

Të shkruarit i ndihmon nxënësit të qartësojnë më tej mendimet e tyre dhe, kështu kur përfshihen në këtë proces, ata mësojnë një llojshmëri metodash.¹² Të shkruarit është i pranishëm në të gjitha lëndët dhe ndihmon në arritjen e rezultateve të larta në çdo lëndë. Mjaft lloje të të shkruarit janë përshtatur për të nxitur strategjitë e të menduarit¹³. **Këtu po rendisin disa nga metodat më të rëndësishme që përmirësojnë të shkruarit.**

Ditari dypjesësh është një metodë që i bën nxënësit të lexojnë në mënyrë të qëllimshme dhe të reflektojnë ndaj saj. Nga informacioni i lexuar, zgjidhet një fragment dhe bëhet komenti i saj, në të cilin nxënësit mund të shprehin qëndrim pohues ose mohues, mund të shkruajnë diçka që u kujtohet nga përvoja e tyre, mund të shkruajnë një pyetje etj. Është një teknikë që përdoret në cikle dhe në lëndë të ndryshme¹⁴. Ditaret e të nxënësve janë ditare dy ose tri pjesësh, që përdoren për të nxitur nxënësit të lexojnë në mënyrë të qëllimshme, të lidhin ngushtë materialin e tekstit me kureshtjen dhe përvojat e veta. Për të bërë ditarin dy pjesësh, hiqet një vijë vertikale në mes të fletës së fletores. Në anën e majtë shkruhen ato pjesë të tekstit, që i tërheqin më shumë vëmendjen nxënësit. Ndoshta ato që kujtojnë diçka, që i intrigojnë më shumë ose ndoshta ato mendime dhe opinione me të cilat ai nuk pajtohet. Në anën e djathtë të fletës shkruhen komente për pjesën.

¹² B. Musai, *Mësimdhënia dhe të nxënësve ndërveprues*, Tiranë, 2005, f. 32.

¹³ B. Musai, *Metodologji e mësimdhënies*, Tiranë, 2014, f. 211.

¹⁴ QTKA, *Mësimdhënia me në qendër nxënësin*, Tiranë, 2005, f. 34.

Dëshmi të metodave të reja në procesin e të shkruarit të nxënësve

<i>Një citat</i>	<i>Komenti i nxënësit</i>

Ditari tri pjesësh: Është një formë tjetër ditari. Ai është i ndarë në tri pjesë.

Kolona e fundit i lihet mësuesit për të vlerësuar, gjykuar dhe dhënë mendime mbikomente që kanë bërë nxënësit.

Një citat	Komenti i nxënësit	Komenti i mësuesit

Kubimi. Është një teknikë që ndihmon shqyrtimin e një teme nga këndvështrime të ndryshme. Në secilën faqe të kubit shkruhen 6 kërkesa, si: përshkruaj, krahaso, shoqëro, analizo, zbato dhe argumento. Për secilën prej tyre nxënësit do të shkruajnë për një afat kohor që cakton mësuesi. Këto kërkesa janë në përputhje me nivelet e taksonomisë së Blumit.

Përshkruaje: Format, shenjat, përmasat, ngjyrat.

Krahasoje: Më kë ngjason? Nga se ndryshon?

Shoqëroje: Çfarë ju bën të mendoni? Çfarë ju vjen në mendje?

Analizoj: Si është ndërtuar? Nga se përbëhet?

Zbatoje: Ç' mund të bëni me të? Si mund të përdoret?

Argumentoje: Merr një qëndrim, pro ose kundër tij.

Mësuesja e ndan klasën në gjashtë grupe. Secilit grup i jep një fishë, e cila ka formën dhe përmasat e faqes së një kubi dhe kërkesat e kubimit. Pasi e plotësojnë fishën nxënësit i ngjisin ato në faqen e kubit. Ato shkëmbejnë përgjigje për secilën faqe të kubit. Veprimtaria organizohet duke punuar në çifte ose në grupe. Çdo partner zgjedh 2-3 faqe të kubit. Më pas shkëmbejnë mendime e lexojnë shkrimet e tyre me partnerin. Pasi lexon një partner, tjetri i përgjigjet duke e lavdëruar ose pyetur. Kjo teknikë përdoret në fazën e realizimit të kuptimit, në të gjitha lëndët dhe në çdo klasë.

1. Përshkruaj klasën.
2. Krahaso klasën tonë me klasën paralele.
3. Shoqëro apo kujto diçka që lidhet me klasën.
4. Analizo. Klasa është e përbërë nga.....
5. Zbato. Nxënësit e klasës sonë janë të kujdesshëm në çdo moment të ditës për sjelljen e njëri-tjetrit.
6. Argumento. Është për t'u vlerësuar fakti, se kohët e fundit

klasa jonë është më e mira në shkollë, kjo për rezultatet e larta në të gjitha lëndët, për sjelljen e mirë etj.

Diagrami i Venit. Është një metodë që përdoret për të bërë krahasime dhe për të gjetur të përbashkëtat ndërmjet dy koncepteve, çështjeve, dukurive, personazheve, pjesëve etj. Ai ndërtohet me ndërprerjen e dy a më shumë rrathëve.

Diagrami i Venit përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta, dallime midis koncepteve të ndryshme si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to. Veprimtaria zgjat 10-20 minuta, por gjithmonë në vartësi të temës dhe të moshës së nxënësve.

Tryeza e rrumbullakët (Gushëkuqi rrethor). Është një metodë bashkëpunuese e cila ka nevojë për një fletë dhe një laps që të realizohet. Letra dhe lapsi pasohen në mënyrë sistematike nga një nxënës te tjetri. Nxënësit janë të vendosur në mënyrë rrethore në një grup të madh ose në grupe më të vogla. Në fillim përcaktohet kahu i lëvizjes së letres, të lapsit që do të fillojë të shkruajë ose të flasë i pari. Kur realizohet me shkrim, fleta paloset në formë firzamonike dhe sapo plotësohet nga një nxënës, kalon te nxënësi tjetër. Gjatë kohës që kjo fletë qarkullon asnjë nxënës nuk e hap për të lexuar çfarë ka shkruar shoku. Përmbajtja e saj lexohet në fund.

Teknika “**Skicimi i një historie**” Është një teknikë krijuese për strategjinë e planifikimit të skenarit bazuar në *Stuhi mendime* e ndarë në grupe.¹⁵

Kjo teknikë ka 4 faza: planifikimin, idetë, organizimin dhe komunikimin. Secila fazë përfshin një seancë krijuese (rreth 45 minuta) dhe një seancë kritike në të cilin pjesëmarrësit kritikojnë skicimin e historisë së tyre. *Faza e planifikimit* fillon me përcaktim problemi. Tema e synuar, 10 -12 kolona, temat (tituj e kolonave), vendosen për të dhënë ide dhe atëherë çështjet listohen nën tituj, titulli i synuar listohet i pari. *Faza e ideve*, tabela e ideve, është marrja e një kolone nga tabela e planifikuar, e cila bëhet tema kryesore dhe çështjet e asaj kolone bëhen tituj të ideve të reja. *Faza e organizimit*, tabela e organizuar, pjesëmarrësit identifikojnë se cili është i përgjegjshëm për në implementimin e zgjidhjeve të zgjedhura,

¹⁵ I. Hoti, *Mbi kuptimësinë e termave “Metodë”, “Strategji”, “Teknikë” në mësimdhënien e gjuhës shqipe*, Buletin i shkencave të edukimit, Shkodër, 2015, f. 223.

çfarë do të ndodhë dhe ku. *Në fazën e komunikimit* –tabela komunikative, pjesëmarrësit identifikojnë kush duhet të komunikojë për të gjithë ngjarjen e identifikuar në tabelën organizative për t’u zhvilluar. Përmes procesit, grafikët vizualë përmbledhin ose paraqesin pikët përkatëse.¹⁶

Pesëvargëshi: Teknikë që shërben për të sintetizuar informacionin sipas disa rregullave dhe një strukture të caktuar.

- a. Rreshti i parë është përshkrimi me një fjalë i temës (zakonisht emër).
- b. Rreshti i dytë është përshkrimi me dy fjalë i temës (dy mbiemra).
- c. Rreshti i tretë përmban tri fjalë që shprehin veprime të temës (dy mbiemra).
- d. Rreshti i katërt është një fjali me katër fjalë që shpreh qëndrimin, ndjenjën për temën 1 fjali.
- e. Rreshti i fundit është një fjalë sinonime me katër fjalë që shpreh qëndrimin, ndjenjën për temën (fjalë sinonime).

Shembull:

(1 emër)

(2 mbiemra)

(3 folje)

(1 fjali përmbledhëse)

(1 sinonim me temën)

Pesëvargëshi

Shqipëria

e lashtë, e bukur

ndërtohet, zhvillohet, ndryshon,

Shqipëria është vendi i të parëve

Atdheu im

Pesëvargëshi është një teknikë që përdoret zakonisht në fazën e reflektimit, meqë bën sintetizimin e informacionit të marrë. Gjen zbatim në çdo lëndë e në çdo klasë. Pesëvargëshi shërben shumë mirë si mjet për të bërë përmbledhjen e informacionit në tërësi; si një mënyrë e vlerësimit të gjykimit të nxënësve; si një mënyrë për shprehje krijuese.

Di-dua të di-mësova më shumë (D.D.M). Është metodë shumë e përdoruar nga mësuesit në fazën e evokimit por edhe në fazat e tjera. Kjo bazohet në përdorimin e një organizuesi grafik që përbëhet nga tri kolona të vendosura në një fletë letre apo kartoni dhe që orienton nxënësit.¹⁷

Në kolonën e parë, “Di”, nxënësit do të shkruajnë atë informacion që u duket si i njohur.

Në kolonën e dytë, “Dua të di”, do të shkruhen pyetje ose kërkesa të nxënësve, rreth çështjeve për të cilat ata kërkojnë të dinë më tepër.

¹⁶ I. Hoti, *Mbi kuptimësinë e termave “Metodë”, “Strategji”, “Teknikë” në mësimdhënien e gjuhës shqipe*, Buletin i shkencave të edukimit, Shkodër, 2015, f. 223.

¹⁷ G. Dibra, M. Taipi, E. Halluni, *Mësuesi dhe mësimdhënia*, Tiranë, 2013, f. 258.

Në kolonën e tretë, “**Mësova**”, nxënësit do të shkruajnë një përmbledhje të informacionit të ri që përvetësuan nga teksti.

Ka më tepër efektivitet kur përdoret me nxënësit e klasës V, VI.

Tërmetet

Di	Dua të di	Mësova
Janë lëkundje të sip. së tokës.	Cilat janë shkaqet?	Shkaktohen nga prishja e ekuilibrave të masave shkëmbore dhe eksplodimit të gazrave.

Diagrama piramidale

Diagrama piramidale është një metodë që i orienton nxënësit në përzgjedhjen e informacionit të përshtatshëm nga një pjesë leximi për t’u analizuar dhe për të marrë parasysh ndikime të shumta të mundshme të tij më pas. (Musai 2005:53). Kjo metodë i përfshin nxënësit në veprimtari të të lexuarit edhe në atë të shkruarit. Zbatimi i metodës kalon në këto faza. Me anë të një pyetjeje që u bëhet nxënësve i orientojmë ata që të përzgjedhin informacionin e duhur nga një pjesë leximi. P.sh. duke u përqendruar në leximin lidhur me Camajn bëjmë pyetjen. Cilat janë veprat që shkroi gjatë gjithë veprës së tij?(poezi, dramë, studime, përkthime, artikuj etj.)U shpërndahen nxënësve fletë të bardha në formë skedash dhe u kërkohet që duke lexuar materialin e dhënë të vendosin në secilën skedë informacionin që lidhet me pyetjen e bërë. Bëhet kategorizimi i informacionit të përzgjedhur duke kërkuar informacion nga fletët e nxënësve. U kërkohet nxënësve të grupojnë fletët të cilat kanë një informacion të përbashkët. Bëjnë kategorizimin e titujve në secilin grupim të fletëve të cilat i vendosim te piramida përmbi çdo kategorie përkatëse. Ndërtojmë dy drejtkëndësha që përfaqësojnë dy shkallët e majës të piramidës. Kërkojmë nga nxënësit të gjejnë një titull i cili të korrespondojë me të gjithë informacionin e fituar gjatë mësimit. Më pas duke përdorur titullin mbi bazën e informacionit të grumbulluar i kërkojmë nxënësve që të formulojnë një fjali e cila të përmbledhë tërë informacionin që është përdorur dhe kategorizimet e bëra. (p.sh. *Arritjet e Camajt në shkrime, poezi, dramë, romane etj.*).

DIAGRAMA PIRAMIDALE

MARTIN CAMAJ

MARTIN
CAMAJ

Arritjet e Martin Camajt në shkrime, gjuhësi, letërsi, dramë, tregojnë se ai ishte njeri me dhunti dhe interesa të shumta

Përparësitë e kësaj metode. Nxënësit ndërtojnë një paraqitje pamore për mënyrën se si përdoren detaje të rëndësishme në nxjerrjen e përfundimeve dhe për të bërë vëzhgime. Nxënësit janë të orientuar në të lexuarit e tyre kështu që kërkojnë në mënyrë aktive informacionin e përshtatshëm nga pjesa e zgjedhur. Nxënësit praktikohen në të shkruarit e përmbledhjeve të tekstit të organizuara mirë.¹⁸

Grupimi i ideve (cluster) është një teknikë që ndërthur të lexuarit dhe të shkruarit. Nxënësve u jepet një temë dhe ata fillojnë të shkruajnë çfarë dinë rreth saj. Idetë hidhen siç mendohen në çast pa u stepur për saktësinë e tyre. Njëkohësisht krijohen edhe lidhje të njohurive me njëra tjetrën. Nxënësit shkruajnë brenda kohës së përcaktuar për veprimtarinë. Kjo është një veprimtari e shkruar që shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të shkruarit, në mënyrë të veçantë për ata që u mungon një dëshirë e tillë. Kjo veprimtari kryhet në faza të ndryshme të mësimin, si dhe me tema të mësuara më parë ose jo.¹⁹

Teknika PMI. PMI (Plus, Minus, Interesante) është një model i zhvilluar nga Eduard de Bono, ekspert në zhvillimin e mendimit kritik. Modelet e tij janë përhapur në të gjithë botën. Kjo teknikë përdoret për të analizuar shpejt dhe në mënyrë të efektshme probleme, çështje, ide, për të marrë një vendim etj.²⁰

PMI përbëhet nga tri kolona nga ku:

¹⁸ B. Musai, *Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues*, Tiranë, 2005, f. 57.

¹⁹ J. L. Steele, K. S. Meredith, Ch. Temple, *Metoda për zhvillimin e mendimit kritik*, Tiranë, 1978, f. 122-123.

²⁰ G. Dibra, M. Taipi, E. Halluni, *Mësuesi dhe mësimdhënia*, Tiranë, 2013, f. 278.

Në kolonën e parë “Plus” shënohen anët e mira (pozitive) të një ideje. Në kolonën e dytë “Minus” shënohen anët e këqija (negative) të një ideje.

Në kolonën e tretë shënohet – Pse ju duket interesante kjo ide, ku hyjnë të gjitha rezultatet e mundshme dhe të nënkuptuara, pozitive, negative apo të pasigurta si p.sh., “Nuk jam i sigurt por më duket interesante fakti.....”.

Plus	Minus	Interesante

Shënime mbi shënime është metodë që siguron në një mënyrë sistematike e cila ndihmon nxënësit të organizojnë informacionin për të lexuarit e tyre, shkrimin dhe studimin. Kjo metodë është një formë e rrjedhshme skicimi. Ideve ose kategorive kryesore u jepet një tregues 1 në radhitje. Attributeve, detajeve ose shembujve u jepet treguesi 2, 3 ose 4. Kjo metodë përfshin këto hapa: Fillojmë duke modeluar shënime mbi shënime duke përdorur kategori të njohura për nxënësit. Tregojmë se si lidhen treguesit me njëri tjetrin. Treguesi 1 është ideja kryesore: gjini letrare. Treguesi 2 janë shembuj të përpunimit të treguesit (kategorisë) 1: proza, poezia, drama. Treguesit 3 janë shembuj të përpunimit të treguesit 2 (prozës): kategori të tilla si: tregimi, novela, romani. Për treguesit 4 nxënësit mund të renditin karakteristika të tilla si: llojet e romanit sipas tematikës: historik, shoqëror, psikologjik, realist ose sipas stilit të rrëfimit, roman i përroit psikik, natyralist, ekspresionist etj.²¹ Shënime mbi shënime i japin nxënësve një mënyrë për të analizuar të shkruarit e tyre sipas strukturës dhe zhvillimit të ideve. Kjo metodë mund të funksionojë shumë mirë me veprimtarinë e hartës së konceptit²². Një zbatim tjetër i metodës *shënime mbi shënime* është edhe metoda *problem me modele*. **Problemi me modele** nxit nxënësit të vënë re fjalitë kryesore, fjalët transitore dhe strukturat e paragrafëve gjatë kohës kur lexojnë. Kjo veprimtari modelon mënyrën si nxënësit të shkruajnë paragrafë dhe ese të organizuara mirë.²³

Nëpërmjet kësaj metode nxënësit bëhen më të vetëdijshëm për strukturën e tekstit kur shkruajnë dhe lexojnë. *Shënime mbi shënime* ofrojnë strategji që lehtëson të kuptuarit për të klasifikuar informacionin. Mund t’i udhëheqin nxënësit në mbajtjen e shënimeve nga tekstet

²¹ B. Musai, *Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues*, Tiranë, 2005, f. 190.

²² B. Musai, *Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues*, Tiranë, 2005, f. 130.

²³ B. Musai, *Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues*, Tiranë, 2005, f. 195.

shkollore apo paraqitjet që bëhen në klasë. Shënimet mbi shënime mund të integrohen me një sërë metodash të tjera për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë si është gërshtuar informacioni.

Teknika “**Skelet peshku**” përdor një organizues vizual për të identifikuar shkaqet e mundshme të një problemi. Në një fletë të gjerë të letrës vizatojmë një shigjetë të gjatë horizontale në mes të faqes me shigjetë në të djathtë. Emërtojmë sipër shigjetës titullin e çështjes që do të shpjegohet. Kjo është shtylla kurrizore e peshkut. Vizatojmë shigjeta nga kurrizi i peshkut me 45 gradë, një për çdo arsye të mundshme të problemit që grupi mund të mendojë dhe emërtoni secilin prej tyre.²⁴

Teknika “**Çelja e zambakut**”. Kjo teknikë mund të përdoret në planifikimin e një skenari. Fillon me një ide rrethuar nga 8 kuti të zbrazëta ose rrethorë. Duke përdorur brainstorming, 8 ide të reja shkruhen në këto kuti. Në hapin tjetër secila nga këto 8 ide bëhet baza e 8 kutive të tjera të zbrazura të cilat mbushen me ide të reja duke përdorur brainstorming. Procesi vazhdon deri në zgjidhje të kënaqshme ose në shfaqjen e një numri të mjaftueshëm të ideve.²⁵

Listë kontrolli. Kjo teknikë përdoret për përmirësimin ose modifikimin e temës. Ajo përfshin modifikimin e një sërë fjalëve, foljeve, mbiemrave ose frazave të përfshira në listën më poshtë: përdor, përshtat, modifiko, zëvendëso, ripërgatit, kombino. Secila folje përmban gjithashtu një përcaktim të zgjeruar në formë pyetjesh.

- *Përshtat*, A ka ndonjë tjetër si kjo? Çfarë do të ju thotë kjo ju? A është e kaluara e krahasueshme?
- *Modifiko*, Jepi një këndvështrim tjetër, ndrysho kuptimin, trajtën etj.
- *Zmadho*, A mund të jetë e dyfishuar, e ekzagjeruar?
- *Zvogëlo*, A mund të hiqet ndonjë gjë? Të bëhet më e vogël? Më e shkurtër?
- *Zëvendëso*, përdoren përbërës të ndryshëm, teori të tjera etj?
- *Ripërgatit*, Shkëmbe përbërës, ndrysho modelin, fjalinë ose shfaqjen? Ndrysho skedën? Zhvendos shkakun ose efektin?

²⁴ I. Hoti, *Mbi kuptimësinë e termave “Metodë”, “Strategji”, “Teknikë” në mësimdhënien e gjuhës shqipe*, Buletin i shkencave të edukimit, Shkodër, 2015, f. 224.

²⁵ I. Hoti, *Mbi kuptimësinë e termave “Metodë”, “Strategji”, “Teknikë” në mësimdhënien e gjuhës shqipe*, Buletin i shkencave të edukimit, Shkodër, 2015, f. 225.

- *Ndërro*, Të kundërtat? Role të kundërta?
- *Kombino*, Kombino njësi, synime ose ide?²⁶

Rrjeti i diskutimit ndërthur katër artet e gjuhës (të lexuarit, të shkruarit, të folurit dhe të dëgjuarit) dhe përfiton nga idetë e të nxënësve në mënyrë të përbashkët duke u dhënë nxënësve mundësi të shumta për të bashkëvepruar.²⁷ Thelbi i kësaj teknike është pyetja binare që pranon përgjigje pozitive dhe negative, që prek direkt thelbin e çështjes ose të problemit. Nxënësit argumentojnë pse janë, pro ose kundër çështjes duke i shënuar në organizuesin grafik. Rrjeti i diskutimit përdoret në fazën e realizimit të kuptimit, ose të reflektimit. Nga diskutimet që kryhen në klasë çdo nxënës kupton se cili është thelbi, çështja e mësimit, shkruajnë ese argumentuese dhe janë të përfshirë të gjithë në diskutim. Zhvillimi i kësaj veprimtarie u siguron fëmijëve lirshmëri maksimale në dhënien e mendimeve, shprehje mendimesh me zë të lartë, shkruarje argumentesh në favor të një çështjeje, përpjekje për të bindur kundërshtarët, lirshmëri në ndërrimin e vendeve gjatë debatit etj.²⁸

Parashikimi me terma paraprake. Kjo metodë e vendos nxënës në rolin e një zbuluesi, duke i dhënë atij koncepte apo terma kryesore të mësimit i cili do të realizohet brenda orës. Zakonisht numri i termave varion nga 4 deri në 6 në varësi të moshës dhe të njohurive që kanë nxënësit. Mësuesi iu jep në përgjithësi nxënësve informacion lidhur me mësimin që do të bëhet. Duke paraqitur para tyre disa nga termat kryesore të mësimit u kërkon atyre në mënyrë individuale të zgjedhin se çfarë përfaqësojnë ato fjalë. Me anë të këtyre fjalëve ata duhet të krijojnë një histori, apo tregim. Pas një periudhe mendimi të nxënësve në mënyrë individuale u kërkohet të ndajnë mendimin apo idetë më shokët e tyre të bankës, duke punuar për pak minuta për të hamendësuar se çfarë përfaqësojnë termat për të ndërtuar historinë. Lexohet informacioni dhe u kërkohet nxënësve se çfarë kanë parashikuar ata vetë më parë. Kjo metodë nxit nxënësit të japin mendime origjinale dhe të zhvillojë imagjinatën. Ndhmon nxënësit të kuptojnë në mënyrë aktive tekstin. Bëhet një aktivizim i plotë i nxënësve drejt një mendimi dhe reagimi më të thellë.²⁹

²⁶ I. Hoti, *Mbi kuptimësinë e termave "Metodë", "Strategji", "Teknikë" në mësimdhënien e gjuhës shqipe*, Buletin i shkencave të edukimit, Shkodër, 2015, f. 226.

²⁷ B. Musai, *Mësimdhënia dhe të nxënësve ndërveprues*, Tiranë, 2005, f. 160.

²⁸ G. Dibra, M. Taipi, E. Halluni, *Mësuesi dhe mësimdhënia*, Tiranë, 2013, f. 275.

²⁹ G. Dibra, M. Taipi, E. Halluni, *Mësuesi dhe mësimdhënia*, Tiranë, 2013, f. 262.

Veprimtaria e të menduarit dhe të lexuarit të drejtuar, DRTA³⁰, është një veprimtari, gjatë së cilës lexuesit nxiten të mendojnë e të parashikojnë rreth asaj që lexojnë. Fëmijët do të mendojnë gjatë kohës që lexojnë; do të parashikojnë dhe do t'i mbajnë shënim parashikimet e tyre. Aktiviteti i të menduarit e të lexuarit të drejtuar (DRTA) mund të përdoret mjaft mirë në fazën e realizimit të kuptimit. Zgjidhen tema, përmbajtja e të cilave ka në qendër një problem, që ndryshon papritur rrjedhë. Kohëzgjatja ndryshon nga 20-25minuta. Përdorimi i kësaj teknike mban gjallë kureshtjen e fëmijëve deri në fund të zbulimit të përmbajtjes së pjesës.

<i>Ç'mendoni se do të ndodhë?</i>	<i>Çfarë provash keni?</i>	<i>Si ndodhi në të vërtetë?</i>

Kjo veprimtari mund të pasojë punën e bërë në fazën e evokimit “Parashikim me terma paraprake”. Për fëmijët e moshës së vogël, mësuesi mund ta lexojë vetë pjesën dhe të kërkojë nga nxënësit të japin mendimet përkatëse. Në këtë rast kemi të bëjmë me veprimtarinë e të menduarit e të dëgjuarit të drejtuar (DLTA)³¹. Fazat e zbatimit janë njësoj si të veprimtarisë DRTA. Metoda dhe teknika të tjera të rëndësishme janë edhe organizuesit e ndryshëm grafikë, që për efekt studimi nuk mund t'i paraqesim këtu si: *harta semantike* etj.³²

Esetë dhe shkrimet e lira përdoren si teknika të cilat i ndihmojnë nxënësit për të sistemuar mendimet e tyre gjatë të shkruarit. Në shkrimin e lirë nxënësit shkruajnë pa u ndalur, pa e ndërprerë dhe pa i shqetësuar për gabimet drejtshkrimore. Shkrimet e lira të kësaj natyre e përgatisin nxënësin për veprimtari krijuese të shkruari. *Ato shërbejnë si thesare krijimtarie individuale*.³³ Shumë mësues i pëlqejnë shkrimet e lira për t'i përdorur për zgjedhjen e ideve interesante për një esse të re që është duke ardhur, duke shmangur në këtë mënyrë paqartësitë që dalin shpesh nga nxënësit në punët e tyre me shkrim.

Metodat dhe teknikat e trajtuara më lart janë procedura standarde që përdorin mësuesit në bashkëpunim me nxënësit për paraqitjen dhe

³⁰ *Directed Reading and Thinking Activity, DRTA.*

³¹ *Directed Listening and Thinking Activity, DLTA.*

³² Shih: E. Bilali, *Organizuesit grafikë - mjet i efektshëm në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve*, në Buletin i Shkencave të Edukimit, Shkodër, 2012, f. 200-205; B. Musai, *Mësimdhënia dhe të nxënësve ndërveprues*, Tiranë, 2005 etj.

³³ QTKA, *Mësimdhënia me në qendër nxënësin*, Tiranë, 2005, f. 35.

zhvillimin e materialeve dhe të veprimtarive mësimore për të arritur qëllimet dhe objektivat mësimore. Për arsye të karakteristikave të grupit të klasës, disa nga metodat dhe teknikat më të suksesshme janë ato që kanë të bëjnë me punën në grup. Këto teknika ndikojnë në aktivizimin më të lartë të lartë të nxënësit në procesin e të nxënës, në ndryshimin e qëndrimeve dhe ideve. Për t'i përdorur metodat me sukses mësuesi duhet të njohë mirë karakteristikat e tyre, ecurinë metodike, t'i përzgjedhë në përshtatje me lëndën që zhvillon dhe me veçoritë e nxënësve. Nuk duhet mbivlerësuar asnjëra prej tyre, por duhen përdorur në mënyrë të kombinuar. Këto teknika mund të përdoren edhe në mësimdhënien me në qendër nxënësien edhe në mësimdhënien me në qendër nxënien dhe gjuhën. Metodot dhe teknikat kërkojnë një strategji nga mësuesi për t'i orientuar drejt nxënësit në përvetësimin, aplikimin apo asimilimin e sintetizimit e njohurive të reja apo edhe atyre të njohura. Brenda një metode mund të përdorim disa teknika. Strategjia që ndjekim për të realizuar një metodë apo teknikë është individuale e mësuesit, për ta përdorur sipas këndvështrimit të tij.

Shkrimi i pavarur i nxënësve është një praktikë që po zë një vend të konsiderueshëm në procesin mësimor. Zbatimi i tij në mësimdhënie ndikon dukshëm në zhvillimin e shprehive të të shkruarit, arrihen rezultate shumë të mira në përvetësimin e lëndëve të ndryshme mësimore dhe rrit efektivitetin e mësimdhënies kur nxënësit përfshihen në të, kur mësimi zhvillohet në mënyrë interesante. Ndaj nëse mësuesit arrijnë t'i përfshijnë nxënësit në një veprimtari deri aty ku të zgjohet interesi dhe motivimi i tyre, atëherë shprehitë e të menduarit dhe gjuha e tyre zhvillohen për të kryer detyra mësimore. Nxënësve duhet t'u paraqesësh një sfidë në të shkruarit e tyre, po të bëhet kjo ata janë të gatshëm të mendojnë gjithnjë e më shumë për botën dhe rolet e tyre.

Mësuesit janë të vetëdijshëm mbi rëndësinë dhe rolin e shkrimit në zhvillimin e të menduarit të nxënësve. Nisur nga kjo themi se sa më të forta të jenë bazat e shprehive të të nxënës tek nxënësit, aq më i qëndrueshëm bëhet të kuptuarit e koncepteve, fakteve dhe ideve të shumta që duhet të mësojnë ata në klasë dhe aq më shumë përsoset të shkruarit e tyre.

Përfitimi i kompetencës³⁴ së re kërkon një angazhim më të madh nga ana e mësuesve, qoftë përse i përket planifikimit të orës, qoftë edhe të

³⁴ Shih: N. KAZMAJ (KALEMI) *Gjuha si kompetencë dhe mësimdhënia e shqipes*, Seminari XXXIV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare Prishtinë, 17-28.08.2015, f. 329-342.

ushtruarit e vazhdueshëm të tyre. Rëndësia e punëve me shkrim është e shumanshme. Nëpërmjet punëve me shkrim, nxënësi shpreh mendimet dhe nivelin intelektual vetjak, paraqet ndjenjat e tij duke mbajtur qëndrim ndaj dukurive jetësore, shpreh shkallën e përvetësimit dhe të zbatimit praktik të njohurive gjuhësore, letrare e drejtshkrimore.

BIBLIOGRAFI

- Bilali, E., *Organizuesit grafikë - mjet i efektshëm në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve*, në Buletin i Shkencave të Edukimit, Shkodër, 2012, f. 200-205.
- Bushati, E., *Evidentimi i problematikave të mundshme gjatë komunikimit me shkrim*, Buletin i Shkencave të Edukimit, Shkodër, 2013, f. 192-196.
- Çerepi, J., *Puna për zhvillimin e të folurit dhe përgatitja e nxënësve për hartim (Klasat V-VI)*, Instituti i Studimeve dhe Botimeve Shkollore, Tiranë, 1965.
- Dibra, G., Taipi, M., Halluni, E., *Mësuesi dhe mësimdhënia*, Tiranë, 2013.
- Elbow, P., *Everyone can write: Essays toward a hopeful theory of writing and teaching writing*, Oxford University Press, 2000.
- Elbow, P., *Writing with power: techniques for mastering the writing process*, Oxford University Press, 2008.
- Grup autorësh, *Didaktika*, Tiranë, 1986.
- Grup autorësh, *Modele për mësimdhënie të suksesshme*, Tiranë, 2001.
- Grup autorësh, *Strategjitë e të mësuarit*, Tiranë, 1995.
- Gjokutaj, M., *Didaktika e gjuhës shqipe*, botim i ShBLU-së, Tiranë, 2009.
- Hoti, I., *Kërkimi në klasë rëndësia metodologjike*, Buletin i Shkencave të Edukimit, Shkodër, 2012, f. 185-191.
- Hoti, I., *Mbi kuptimësinë e termave "Metodë", "Strategji", "Teknikë" në mësimdhënien e gjuhës shqipe*, Buletin i shkencave të edukimit, Shkodër, 2015, f. 220-227.
- Hoti, I., *Një vështrim mbi kurrikulën e gjuhës shqipe*, Buletin i Shkencave të edukimit, Shkodër, 2011, f. 87-192.
- Instituti i Kurrikulës dhe i Trajnimit, *Metodat ndërvepruese të mësimit*, Tiranë 2008.
- Instituti i Studimeve Pedagogjike, *Vlerësimi i nxënësve*, Tiranë, 1996.
- Kadiu, A., *Punët me shkrim, qortimi dhe vlerësimi i tyre*, Tiranë, 2002.
- Kadriu, D., *Strategjitë e mësimdhënies që i zhvillojnë tek nxënësit kompetencat: Komunikimi dhe të shprehurit si dhe kompetencën e të menduarit*, Java e Shkencës, Prishtinë, 2015, f. 52.

- Kazazi, Nj., Garuci, N., Zhabjaku, N., *Didaktikë e gjuhës shqipe*, botim i ShBLU-së, Tiranë, 2005.
- KAZMAJ (KALEMI) N., *Gjuha si kompetencë dhe mësimdhënia e shqipes*, Seminari XXXIV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare Prishtinë, 17-28.08.2015, f. 329-342.
- Koci, K., *Probleme të mësimit të gjuhës shqipe*, 1987.
- Mialaret, G., *Pedagogjia e përgjithshme*, botim i ISP-së, ShB “Faik Konica”, Tiranë, 1995.
- Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, *Metodika e hartimit*, Tiranë, 1961.
- Musai, B., *Metodologji e mësimdhënies*, Tiranë, 2003, 2014.
- Musai, B., *Mësimdhënia dhe të nxëniet ndërveprues*, Tiranë, 2005.
- Musai, B., *Si të shkruajmë esse*, Tiranë 2009.
- Nishku, M., *Si të shkruajmë – Procesi dhe shkrimet funksionale*, Botim i CDE, Tiranë, 2004.
- Papahristo, S., *Ushtrimet gjuhësore dhe hartimet në shkollat fillore dhe të mesme*, botim i Ministrisë s’Arsimit, Shtëpia Botonjëse “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1938.
- Qendra për Arsim Demokratik (CDE), *Mësimdhënia dhe të nxëniet ndërveprues – Modele për zhvillimin e të menduarit kritik* (Shkencat shoqërore, për klasat 6-12), Tiranë, 2005.
- QTKA, *Mësimdhënia me në qendër nxënësin*, Tiranë, 2005.
- Rrahmani, Z., *Leximi dhe shkrimi*, Shtëpia botuese “Faik Konica”, Prishtinë 2003.